



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i Lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 23 prill 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për Dhënien e Privilegjeve
Këshilltares Juridike**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUP GJYKUES II ("Trupi Gjykses "), në bazë të neneve 1(2), 21, dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullave 2(1), 26(1) dhe 111(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), pjesëve 9, 12-13, dhe 18(3)(b)-(d) e (4) të Direktivës për Mbrojtësit ("Direktiva"),¹ neneve 6(1)(b) dhe 26 të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Kodi i Etikës Profesionale"),² dhe neneve 4(2), 6(5) dhe 9(4) të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit: Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve ("Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve")³, lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 1 dhjetor 2023, Trupi Gjykses lëshoi vendim për modifikimin e kushteve të paraburgimit për tre të akuzuar ("Vendimi F01977").⁴
2. Më 20 shkurt 2024, Trupi Gjykses lëshoi urdhër gojor lidhur me përgjegjësinë e mbrojtësit që buron nga Direktiva dhe Kodi i Etikës Profesionale ("Urdhri Gojor").⁵
3. Më 15 mars 2024, Mbrojtja e Rexhep Selimit (përkatësisht, "z. Selimi" dhe "Mbrojtja e Selimit") i kërkoi Trupit Gjykses që privilegji i komunikimit klient-mbrojtës që gëzon aktualisht Dr. Rudina Jasini, bashkëmbrojtëse e z. Selimi, t'i

¹ KSC-BD-04-Rev2, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Direktivë për Mbrojtësit, 22 shkurt 2024.

² KSC-BD-07/Rev1, Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 28 prill 2021.

³ KSC-BD-10-Rev1, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit: Vizitat dhe Komunikimet, 23 shtator 2020.

⁴ F01977, Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, 1 dhjetor 2023.

⁵ Transkripti i seancës, 20 shkurt 2024, f. 12506, rreshti 15, deri në f. 12508, rreshti 20.

jepet edhe si këshilltare juridike ("Kërkesa e Mbrojtjes së Selimit").⁶ Mbrojtja e Selimit argumenton se kjo do t'i mundësonte Dr. Jasinit të vazhdojë të ketë komunikime dhe vizita të privileguara me z. Selimi.⁷

4. Më 20 mars 2024, Zyra Administrative dorëzoi parashtrimet në lidhje me Kërkesën ("Parashtrimet e Zyrës Administrative"), duke argumentuar se duhet zbatuar korniza ligjore e Dhomave të Specializuara ("DHS"), sipas së cilës privilegji i komunikimit mbrojtës-klient nuk u jepet këshilltarëve juridikë. Zyra Administrative gjithashtu thekson se, sidoqoftë, anëtarët e ekipit të mbrojtjes, të cilët nuk gëzojnë të drejtën e vizitave dhe komunikimeve të privileguara kur takohen vetëm për vetëm me z. Selimi, mund të kenë vizita dhe komunikime të privileguara kur shoqërohen nga mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi.⁸

5. Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk u përgjigj ndaj Kërkesës.

II. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

6. Në bazë të rregullës 26(1) të Rregullores dhe pjesës 12 të Direktivës, Administratori emëron ose cakton mbrojtës nga Lista e Mbrojtësve të Specializuar për një të dyshuar ose të akuzuar.

7. Në bazë të rregullës 111, komunikimet e bëra në kontekstin e marrëdhënies profesionale ndërmjet një personi dhe Mbrojtësit të tij të Specializuar, konsiderohen të privileguara.

8. Në bazë të nenit 6(1)(b) të Kodit të Etikës Profesionale, në kuadër të roleve përkatëse të tyre në procedura, mbrojtësit dhe prokurorët respektojnë fshehtësinë dhe konfidencialitetin profesional.

⁶ F02185, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit për Dhënien e Privilegjeve Këshilltares Juridike*, 15 mars 2024, para. 1, 22.

⁷ *Shih* Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit, para. 3, 13, 20.

⁸ F02190, Zyra Administrative, *Parashtrime të Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për Dhënien e Privilegjeve Këshilltares Juridike*, 20 mars 2024, me Shtojcën 1, konfidenciale.

9. Në bazë të neneve 4(2) dhe 6(5) të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësit, vizitat dhe komunikimet mes të paraburgosurit dhe mbrojtësit (dhe bashkëmbrojtësit) janë të privileguara.

10. Në bazë të nenit 9(4) të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve, anëtarët e ekipit të mbrojtësit mund ta shoqërojnë mbrojtësin gjatë kohës që viziton të paraburgosurin.

III. DISKUTIM

11. Korniza ligjore e DHS-së përcakton balancën e duhur midis disa privilegjeve që i jepen mbrojtësit të një të akuzuari dhe detyrimeve që ka mbrojtësi në ushtrimin e përgjegjësisë të veta. Këto dy aspekte lidhen ngushtë me njëri-tjetrin meqenëse synojnë të garantojnë përfaqësimin efektiv të të akuzuarit në njërën anë, dhe, në anën tjetër, sigurojnë që mbrojtësi të kryejë detyrën e vet në përputhje me detyrimet dhe standardet etike. Në këtë kontekst, korniza ligjore e DHS-së përcakton se: (i) komunikimet e privileguara janë ato të bëra “në kontekstin e marrëdhënies profesionale ndërmjet një personi dhe Mbrojtësit të tij të Specializuar”;⁹ dhe (ii) Mbrojtësi i Specializuar është person në Listën e Mbrojtësve të Specializuar që i caktohet ose emërohet një të dyshuari ose të akuzuari, ose (që i përmbush kriteret të) zgjidhet për të vepruar si bashkëmbrojtës, në përputhje me Direktivën.¹⁰ Këto privilegje nuk u jepen anëtarëve të tjerë të një ekipi të mbrojtjes, të cilët po ashtu nuk kanë të njëjtat detyra dhe përgjegjësi që janë detyruese për mbrojtësin.

12. Trupi Gjykses vëren veçanërisht se mbrojtësi dhe bashkëmbrojtësi kanë detyrimin të zbatojnë Kodin e Etikës Profesionale, i cili përcakton standardet profesionale bazë që duhet të përmbushin mbrojtësit, bashkëmbrojtësit dhe

⁹ Rregulla 111(1).

¹⁰ Rregulla 2(1) dhe 26(1). *Shih gjithashtu* Pjesët 12, 18(1) dhe (4) të Direktivës.

prokurorët të cilët ushtrojnë profesionin para DHS-së, përfshirë detyrimin e respektimit të konfidencialitetit dhe fshehtësisë profesionale.¹¹ Në këtë aspekt, Kodi i Etikës garanton që mbrojtësit, bashkëmbrojtësit dhe prokurorët të mbahen përgjegjës për sjellje kundërvajtëse dhe përcakton rregullat disiplinore të zbatueshme në lidhje me ta.¹² Sipas këtyre rregullave disiplinore, me përjashtim të mbrojtësit ose bashkëmbrojtësit, anëtarët e ekipit të mbrojtjes, përfshirë këshilltarët juridikë ("anëtarët e ekipit të mbrojtjes"), nuk janë drejtpërdrejt përgjegjës sipas Kodit të Etikës Profesionale, dhe standardi disiplinor dhe detyrimet e parashikuara aty në lidhje me anëtarët e ekipit të mbrojtjes mund të vendosen vetëm nëpërmjet mbrojtësit ose bashkëmbrojtësit në pozitë eprore.¹³

13. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve përcakton se: (i) si mbrojtësi ashtu edhe bashkëmbrojtësi kanë të drejtën e vizitave dhe komunikimeve të privileguara me të paraburgosurin që përfaqësojnë;¹⁴ dhe (ii) anëtarët e ekipit të mbrojtjes mund ta shoqërojnë mbrojtësin ose bashkëmbrojtësin kur vizitojnë të paraburgosurin, dhe këto vizita trajtohen si të privileguara në të njëjtën masë si vizitat e tjera të mbrojtësve sipas Udhëzuesit të Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve.¹⁵

14. Bazuar në dallimet e mësipërme midis mbrojtësit dhe anëtarëve të tjerë të ekipit të mbrojtjes, Vendimi F01977 bëri ndarjen mes vizitave të privileguara (ku janë të pranishëm mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi) dhe vizitave të të akuzuarit nga anëtarë të tjerë të ekipit të mbrojtjes (pa praninë e mbrojtësit ose të bashkëmbrojtësit), të cilat nuk janë të privileguara.¹⁶ Trupi Gjykses konkretisht përcaktoi, ndër të tjera, se për të gjitha vizitat dhe bisedat telefonike jo të

¹¹ Kodi i Etikës Profesionale, nenet 6(1)(b), 26.

¹² *Shih* Kodin e Etikës Profesionale, nenet 3(2) dhe 33(1).

¹³ Kodi i Etikës Profesionale, neni 34.

¹⁴ Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve, nenet 4(2), 6(5).

¹⁵ Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve, nenet 9(4).

¹⁶ Vendimi F01977, para 60-61.

privileguara duhej miratim paraprak i Administratores.¹⁷

15. Trupi Gjykues gjykon se Mbrojtja e Selimit nuk ka demonstruar se planifikimi paraprak që tani është i domosdoshëm për kontaktet e të akuzuarit me anëtarët e ekipit të mbrojtjes pas zbatimit të vendimit F01977, efektivisht lejon vetëm komunikimet me mbrojtësin. Trupi Gjykues vëren se, sikurse argumenton Zyra Administrative dhe në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes së Selimit,¹⁸ z. Selimi edhe më tej mund: (i) të ketë vizita të privileguara me mbrojtësin dhe bashkëmbrojtësin, të shoqëruar nga anëtarë të tjerë të ekipit të mbrojtjes, nëse dëshirojnë; (ii) të ketë thirrje telefonike të privileguara me mbrojtësin dhe bashkëmbrojtësin; dhe (iii) të ketë vizita dhe thirrje telefonike jo të privileguara me anëtarë të ekipit të mbrojtjes që nuk shoqërohen nga mbrojtësi apo bashkëmbrojtësi, me kushtin që për këto vizita dhe thirrje telefonike tani kërkohet miratim paraprak nga Administratorja. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues gjykon se korniza ligjore në fuqi në lidhje me komunikimet e privileguara, sikurse shtjellohet më lart,¹⁹ nuk është ndryshuar me Vendimin F01977, dhe si rrjedhim nuk janë ndryshuar as privilegjet ligjore të z. Selimi.

16. Gjithashtu, Trupi Gjykues nuk është bindur se rrethanat që ka paraqitur Mbrojtja e Selimit për ligjin dhënien e privilegjeve ligjore në këtë rast. Së pari, rregullat aktuale janë në përputhje të plotë me nevojat e Mbrojtjes së Selimit për t'u përgatitur dhe me mbrojtjen efektive të të drejtave të të akuzuarit. Së dyti, rregullat e cekura më lart sigurojnë balancën e duhur dhe të nevojshme midis interesave të të akuzuarit dhe interesave publike të tjera relevante për këtë aspekt, përfshirë mbrojtjen e informacionit konfidencial. Së treti, Mbrojtja e Selimit nuk ka vërtetuar se detyrat dhe përgjegjësitë që do t'i caktohen Dr. Jasinit nuk mund të kryhen në mënyrë efektive brenda kornizës ekzistuese. Së fundi, Trupi Gjykues

¹⁷ Vendimi F01977, para. 60.

¹⁸ Parashtrimet e Zyrës Administrative, para 17-18; Kërkesa e Mbrojtjes së Selimit, para 9-11.

¹⁹ *Shih* më lart, para. 11-13.

vëren dhe rithekson se duket se z. Selimi u përfshi në nxjerrjen e informacionit konfidencial për palë të treta të paautorizuara.²⁰ Kjo, si dhe atmosfera e ndërhyrjes të dëshmitarët në të cilën zhvillohet ky gjykim, kërkojnë një qasje posaçërisht të kujdesshme ndaj privilegjeve ligjore. Mbrojtja e Selimit nuk ka demonstruar se janë vërtetuar arsye mjaftueshëm bindëse për të devijuar nga rregullat ekzistuese në këtë çështje.

17. Trupi Gjykses vëren se jurisprudenca të cilës i referohet Mbrojtja e Selimit nuk mbështet dhënien e kërkuar të privilegjit të komunikimit klient-mbrojtës në këtë çështje gjyqësore.²¹ Së pari, asnjë prej shembujve të cituar nga jurisprudenca nuk mund të krahasohet me çështjen aktuale. Gjithashtu, ato çështje gjyqësore dallojnë nga kjo në disa aspekte juridikisht thelbësore: (i) Dhoma e Procedurës Paraprake e GJPN-së miratoi dhënien e privilegjeve ligjore administratorit të lëndës të ekipit të mbrojtjes në çështjen Ngaisona sepse ekipi nuk kishte një bashkëmbrojtës, dhe Dhoma e Procedurës Paraprake tërhoqi privilegjet kur ekipi u plotësua me anëtarë që kishin të drejtën e komunikimeve të privilegjuara;²² dhe (ii) dhënia e privilegjeve ligjore me urdhrin e cituar në çështjen *Turinabo dhe të tjerët* u bë në rrethana të jashtëzakonshme ku kryembrojtësi dhe i akuzuari ishin në dy shtete të ndryshme për shkak të pandemisë COVID-19.²³ Trupi Gjykses konstaton se nuk ekzistojnë rrethana të ngjashme që do të përligjin dhënien e

²⁰ *Shih, për shembull*, F02182, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 15 mars 2024, para. 22, që i referohet Vendimit F01977, para. 35-37.

²¹ Kërkesa e Mbrojtjes së Selimit, para 16-17, që i referohet ICC, *Prosecutor v. Yekatom and Ngaissona*, ICC-01/14-01/18-176-Red2, Pre-Trial Chamber II, Public Redacted Version of “Decision Pursuant to Regulation 101 of the Regulations of the Court” (“[Yekatom and Ngaissona First Decision](#)”), 8 February 2021 (date of original: 15 April 2019); IRMCT, *Prosecutor v. Turinabo et al.*, MICT-18-116-PT, Single Judge, Order on the Extension of Attorney-Client Privilege (“[Turinabo et al. Order](#)”), 25 September 2020.

²² [Yekatom and Ngaissona First Decision](#), para. 34; ICC, *Prosecutor v. Yekatom and Ngaissona*, ICC-01/14-01/18-712-Red, Trial Chamber V, Public Redacted Version of “Decision on the Ngaissona Defence Request on the Scope of Privileged Communications” (“[Yekatom and Ngaissona Second Decision](#)”), 16 February 2021 (date of original 4 November 2020), para. 21.

²³ [Turinabo et al. Order](#), f. 2.

privilegjit të komunikimit klient-mbrojtës në rrethanat aktuale.²⁴

18. Trupi Gjykues është gjithashtu i mendimit se ndryshimi i roleve dhe përgjegjësi të anëtarëve të ekipit të mbrojtjes që kërkon të bëjë Mbrojtja e Selimit për zbatimin e Urdhrit Gojor dhe Vendimit F01977, nuk përbën arsye të vlefshme për dhënien e privilegjeve ligjore atyre që nuk i gëzojnë këto privilegje sipas kornizës ligjore të DHS-së.²⁵ Urdhri i Trupit Gjykues kishte për qëllim të siguronte se të gjithë ata që veprojnë si mbrojtës për një të akuzuar janë në gjendje dhe të gatshëm të kryejnë detyrimet dhe përgjegjësitë që lidhen me këtë funksion. Kur nuk janë mbrojtës, atyre duhet t'u jepet rol tjetër. Sikurse u përshkrua më lart, për rolet e tjera ka të drejta dhe përgjegjësi të tjera të ndryshme. Mbrojtja e Selimit nuk ka vërtetuar në këtë rast se mbrojtësi gëzon vetëm privilegjet por nuk ka përgjegjësi në lidhje me rolin e tij.

19. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk është bindur se zbatimi më i gjerë i privilegjit të komunikimi klient-mbrojtës që përcaktohet shprehimisht në kornizën ligjore të DHS-së, përlicjet në këtë fazë.²⁶

20. Për këto arsye, Trupi Gjykues refuzon t'i japë Dr. Jasinit privilegjin e komunikimit klient-mbrojtës nëse ajo kthehet në pozitën e mëparshme si këshilltare juridike. Rrjedhimisht, kërkesa e Mbrojtjes së Selimit rrëzohet.

²⁴ Shih [Yekatom and Ngaïssona Second Decision](#), para. 21.

²⁵ Shih ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-3080, Trial Chamber III, Decision on "Defence Motion on Privileged Communications" ("[Bemba Decision](#)"), 3 June 2014, para. 21.

²⁶ [Bemba Decision](#), para. 22.

IV. VENDIM

21. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

RRËZON Kërkesën e Mbrojtjes të Selimit.

/nënshkrimi/

Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 23 prill 2024

Në Hagë, Holandë.